



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:063180

Datë: 09.11.2022

Numri i dokumentit: 03626897

PKR.nr.100/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetar i trupit gjykues-gjyqtari Mentor Hajraj, me natarët e trupit gjykues-gjyqtaret Gezim Ademi dhe Zoran Paviq, me procesmbajtësen- zyrtare ligjore Edita Kelmendi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit D.S për shkak të veprës penale Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.126/2022 të datës 12.04.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor me datën 28.10.2022, i cili ka qenë i hapur për publikun ku kanë prezantuar Prokurorja e Shtetit Fetije Bajrami dhe i akuzuari D.S, të njëjtën ditë ka marrë dhe publikisht në prezencë të të akuzuarit dhe në mungesë të prokurores së shtetit ka shpallur, ndërsa me dt.09.11.2022, e ka përpiluar me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

KUNDËR: Te akuzuarit **D.S**, nga i ati Shaban, e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur me .. në Skenderaj, me adrese banimi në fsh..., Komuna e Skenderajt, i pa martuar, i pa punë, ka të përfunduar shkollën e mesme, tani student në UP-Fakulteti për Shkenca Politike, shqiptarë, shtetase i Republikës së Kosovës, me numër të letërnjoftimit ...

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: Me datën 06.10.2019, në fsh.Çubrel Komuna e Skenderajt, në shkollën fillore “Vellezerit Frasheri”, i pandehuri në cilësinë e kryesuesit të Këshillit të Vendvotimit në Qendrën e Votimit 2102B, vendvotimi me Nr.2102B/02D, duke e shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare apo

autoritetin zyrtar në lidhje me zgjedhjet ka shtuar dhe hequr votat, në atë mënyrë që pas rinumërimit në Qendrën e Numërimit të Rezultateve është bërë krahasimi i të dhënave ku është identifikuar ndryshimi i votave, ashtu që gjatë numërimit të votave të kandidatëve brenda subjektit politik, ka hequr votat e disa kandidatëve dhe i ka shtuar të disa kandidatëve të tjerë duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë gjithsej 102 vota, ku prej tyre 84 vota të shtuara dhe 18 vota të hequra.

- **Me këtë ka kryer veprën penale: Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 7, 17, 21, 38, 46, 47, 48,49, 69, 71, 72 par.1 pika 1.3 dhe neni 216 par.2 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPP-së:

S H Q I P T O N

-Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën prej dy (2) vitesh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nuk do të kryej vepër tjetër penale.

-I pandehuri obligohet qe te paguaj ne emër te shpenzimeve të procedurës penale shumën prej tridhjetë (30) Euro, në emër të paushallit gjyqësor shpenzimet ne lartësi prej njëzet (20) Euro, ndërsa ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit shumen prej pesëdhjetë (50) euro, te gjitha këto 15 dite pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

-Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk pati.

A r s y e t i m i

- **Aktakuza:**
Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda, ka parashtruar Aktakuzën, me numër- PP.I.nr.126/2022 të datës 12.04.2022, ndaj të akuzuarit D.S, për shkak të veprës penale: Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK-së.

- **Rrjedha e procedurës:**

Për këtë çështje penale fillimisht është caktuar seanca e shqyrtimit fillestar me datën 24.06.2022, në të cilin shqyrtim kanë prezantuar i akuzuari dhe prokurorja e shtetit. Në shqyrtimin fillestar i akuzuari e ka mohuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës.

Në këtë çështje penale nuk është mbajtur shqyrtimi i dytë, por te akuzuarit i është dhënë mundësia të paraqesë kundërshtim apo kërkesë për hudhje te aktakuzës brenda afatit të përcaktuar dhe duke u mbështetur në nenin 245 paragrafi 5 të KPP, kurse brenda këtij afati i akuzuari ne gjykate nuk ka paraqitur Kërkesë për hudhje te aktakuzës dhe kundërshtim ndaj provave.

Seanca e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale është mbajtur më 28.10.2022. Seanca e shqyrtimit gjyqësor ka qenë e hapur për publikun, në të cilin shqyrtim kanë prezantuar prokurorja e shtetit dhe i akuzuari. Në shqyrtim gjyqësor gjykata të akuzuarin e ka njoftuar me të drejtat e tij në cilësinë e palës së akuzuar. I njëjti ka deklaruar së i ka kuptuar të drejtat e tij, ndërsa për mbrojtës nuk ka angazhuar askënd dhe mbrojtjen e ka paraqitur vet.

Gjatë kësaj seance të shqyrtimit gjyqësor, gjykata i ka dhënë mundësi të akuzuarit edhe një herë që të deklarohet lidhur me pranimin e fajësisë.

I akuzuari në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se e kupton akuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe pas bindjes së kryetarit të trupit gjykues se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, dhe pasi që është njoftuar për pasojat dhe benificionet që parasheh ligji lidhur me pranimin e fajësisë, i pandehuri është deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

- **Administrimi i provave materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor:**

Gjykata ne shqyrtim gjyqësor administroje provat e propozuara nga prokuroria ne aktakuze dhe atë:

- Libri i Votimit për vendvotim Nr.2102B/02D.
- Formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve të rinumëruara në QNR.
- Formulari i përputhjes së të dhënave të kandidatëve të krijuara në vendvotim Nr.2012B/02D dhe e numëruar në QNR.

- Tabela Excel e specifikuar me emrin e kandidatit, subjektit politik dhe pasqyra e votave të numëruara në vendvotim dhe rezultati pas rinumërimit në QNR (votat të cilat janë hequr apo shtuar).

Ne shqyrtim gjyqësor prokurorja e shtetit është tërhequr nga propozimi si ne aktakuze qe si dëshmitar te dëgjohe zyrtalet nga Qendra e Rinumërimit(QNR), S.F dhe A.S.

I akuzuari ne shqyrtim gjyqësor ka propozuar qe si dëshmitar te ftohen për tu dëgjuar te gjithë anëtarët e komisionit te vendvotimit ne te cilin ai ka qene kryesues përkatësisht te vendvotimit NR2102B/02D.

Gjykata pas marrjes se mendimit edhe te prokurores se shtetit ka refuzuar propozimin e te akuzuarit me arsyetimin se për gjykatën dëshmia e këtyre personave te propozuar është e parëndësishme për faktin se ky vendvotim pasi ka shkuar ne rinumërim ne QNR janë evidentuar mospërputhje te votave qe kane rrjedhur nga kjo qendër e votimeve. Përveç kësaj ne shkresa te lendes gjykata kishte edhe prova tjera ne te cilat do ta bazonte vendimin e saj. Andaj këtë propozim te te akuzuarit e vlerësoi vetëm si përpjekje për zvarritjen e procedurës penale.

- **Pretendimet e palëve- fjala përfundimtare;**

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetem në tërësi pranë aktakuzës së ushtruar ndaj të pandehurit D.S për veprën e cekur si në aktakuzë, për arsye se në të gjitha provat materiale që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se ky i pandehur e ka kryer këtë vepër penale në mënyrën siç ceket edhe në dispozitiv të Aktakuzës, se e ka kryer këtë vepër penale u vërtetua edhe nga vet deklarata e të pandehurit kur ka theksuar se ka mundur të ndodhë të lëshojë gabime teknike për shkak të lodhjes së tepërt edhe pse këto kanë qenë pa dashjen e tij, andaj i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I pandehuri D.S në fjalën përfundimtare deklaroi se jam i pafajshëm dhe i propozoj gjykatës që të liroj nga aktakuza për shkak se unë asnjëherë nuk jam përballur me asnjë proces gjyqësor, kam bashkëpunuar në çdo fazë të këtij procesi dhe një vendim tjetër do të më ndikonte shumë moralisht dhe do të paraqiste pengesa në të ardhmen.

- **Paraqitja e mbrojtjes nga i pandehuri;**

I pandehuri në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se dëshiroj të paraqes mbrojtjen ndërsa fillimisht deklaroj se qëndroj në tërësi pranë deklaratës së datës 31.03.2022 dhënë në policinë e Kosovës- Stacionin Policor në Skenderaj lidhur me këtë çështje. Ndër ne mbrojtjen e tij ne shqyrtim gjyqësor nder te tjera ka deklaruar se kam qenë kryesues në vendvotimin në fshatin Çubrel-Skenderaj, detyrat e mia kanë qenë me udhëheq vendvotimin, t'i përcjellë anëtarët e komisionit dhe çdo gjë që shkruhet në librin që kam pasur afër vetës qoftë parregullsi apo ndërrim të vëzhguesve apo komisionarëve, pra të gjitha që kanë pasur të bëjnë me procesin e votimit, e përveç kësaj detyrë e imja së bashku edhe me katër komisionarët të tjerë ka qenë edhe kontrollimi i përputhjes së votave të kandidatëve. Po ashtu, ka deklaruar se nuk ka qenë qëllimi im ta ndryshoj vullnetin e qytetarëve, ka mundur të ndodhë kur gjatë shënimeve të vijave horizontale dhe vijave vertikale meqenëse zakonisht votat numërohet me vija ku katër vota shënohen me vija horizontale ndërsa vija e pestë shkruhet vertikal dhe mbyllet, të harrojmë një vijë apo të mos e mbyllim një rubrikë dhe për shkak të kësaj të na dërgoj deri tek mospërputhja e rezultatit final.

Faktet jo kontestuese;

Gjykata në këtë rast duke u bazuar në provat materiale, mbrojtjen që ka paraqitur i pandehuri, pretendimet e prokurorit të shtetit, ka vërtetuar faktet jo kontestuese si në vijim;

- Nuk është kontestues fakti se i pandehuri ka qenë kryesues në Qendrën e vendvotimit 2012B/02D në shkollën fillore “Vëllezërit Frashëri” në fshatin Çubrel, Komuna e Skenderajt.
- Nuk është kontestues fakti që pas rinumërimit në Qendrën e Numërimit të Rezultateve pasi që është bërë krahasimi i të dhënave ku është identifikuar ndryshimi i votave, brenda subjektit politik, i pandehuri ka hequr votat e disa kandidatëve dhe i ka shtuar të disa kandidatëve të tjerë duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë gjithsej 102 vota, ku prej tyre 84 vota të shtuara dhe 18 vota të hequra.

- **Analizimi i provave;**

-Nga Libri i Votimit për vendvotim Nr.2102B/02D vërtetohet se i pandehuri D.S ka qenë Kryesues i vendvotimit në fshatin Çubrel-Skenderaj, dhe në këtë libër ceket koha e fillimit të procesit që ka qenë në orën 07:00, si dhe shihen edhe shënimet mbi procedurat e votimit gjatë ditës së zgjedhjeve.

-Nga Formulari i përputhjes së të dhënave të kandidatëve të krijuara në vendvotim Nr.2012B/02D dhe e numëruar në QNR vërtetohet se i pandehuri si kryesues e ka nënshkruar këtë formular të rezultateve të votimit dhe me nënshkrimin e tij është vërtetuar se shifrat në këtë formular pasqyrojnë rezultatet në vendvotimin ku ka qenë i angazhuar si kryesues.

-Nga Formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve të rinumëruara në QNR, vërtetohet se me nënshkrimin e të pandehurit si kryesues me dt.14.10.2019 janë rinumëruar përsëri votat në këtë vendvotim.

Nga Tabela Excel e specifikuar me emrin e kandidatit, subjektit politik dhe pasqyra e votave të numëruara në vendvotim dhe rezultati pas rinumërimit në QNR (votat të cilat janë hequr apo shtuar) vërtetohet se pas rinumërimit të votave ka dallime në vota nga votat para rinumërimit dhe votat pas rinumërimit, ku disa kandidatëve i janë shtuar votat ndërsa disa kandidatëve i janë hequr dhe atë gjithsej në mënyrë jo të saktë janë regjistruar 102 vota, prej tyre 84 vota të shtuara dhe 18 vota të hequra (të shtuara: subjektit politik PDK 67 vota, NISMA-AKR 2 vota, FJALA 1 votë, LVV 12 vota, LDK 2 vota; ndërsa të hequra: subjektit politik PDK 11 vota, NISMA-AKR 5 vota, LVV 2 VOTA).

- Vlerësimi i gjykatës;

Gjykata përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri ditën kritike në cilësinë e kryesuesit të këtij vendvotimi me dashje duke keqpërdorur pozitën e tij disa kandidatëve i'a ka hequr votat e disa të tjerëve i'a ka shtuar votat kështu që pas rinumërimit ka pasur dallime në rezultate të votave për shumë kandidatë pasi që i njëjti i ka regjistruar ato në mënyrë jo të saktë.

Andaj, trupi gjykues pas admistrimit të provave dhe analizimit të secilës prej tyre një nga një e më pas edhe të gjitha së bashku e ka vërtetuar se i pandehuri D.S me datën 06.10.2019 në fsh.Çubrel Komuna Skenderaj, në shkollën fillore 'Vellezerit Frasheri', i pandehuri në cilësinë e kryesuesit Këshillit të Vendvotimit në Qendrën e Votimit 2102B, vendvotimi me Nr.2102B/02D duke e shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare apo autoritetin zyrtar në lidhje me zgjedhjet ka shtuar dhe hequr votat, në atë mënyrë që pas rinumërimit në Qendrën e Numërimit të Rezultateve është bërë krahasimi i të dhënave ku është identifikuar ndryshimi i votave, ashtu që gjatë numërimit të votave të kandidatëve brenda subjektit politik, ka hequr votat e disa kandidatëve dhe i ka shtuar

të disa kandidatëve të tjerë duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë gjithsej 102 vota, ku prej tyre 84 vota të shtuara dhe 18 vota të hequra.

Gjykata, në bazë të të lartcekurave është e bindur se në veprimet e të pandehurit D.S, përmbushen të gjitha elementet e veprës penale: Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK-së, pasi qe sipas kësaj dispozite ligjore këtë veprë penale e kryen *“kushdo qe shton, heq apo fshin votat apo nënshkruan, regjistron ne mënyrë te pasaktë votën apo rezultatin e zgjedhjeve ne dokumentet zgjedhore....., ndërsa paragrafi 2 i këtij neni ” kur vepra penale nga par.1 kryhet nga anëtari i komisionit zgjedhor ose ndonjë person tjetër ne keqpërdorim te detyrave, pozitës apo autorizimeve te tij ne zgjedhje ose ne votim.*

Ne rastin konkret pas administrimit te provave ne shqyrtim gjyqësor u vërtetua se i akuzuari ka hequr votat e disa kandidatëve dhe i ka shtuar të disa kandidatëve të tjerë duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë gjithsej 102 vota, ku prej tyre 84 vota të shtuara dhe 18 vota të hequra, dhe kete e ka bere ne cilesin e kryesuesit te Keshillit te vendvotimit.

Sipas nenit 102 par.2 te Ligjit nr.03/L-073, per Zgjedhjet e Pergjithshme ne Republiken e Kosoves, *“kryesuesi i komisionit e qe ne rastin konkret per ate vend votim ishte i akzuar D.S, eshte pergjegjes per permbledhjen dhe sakesin e rezultateve te votimit”.*

Ne rastin konkret siq u cek edhe me larte i akuari nuk e ka permbushur pergjegjesin e tij qe burone nga kjo dispozite ligjore, me qka gjykatat konstatoje se ka kryer veprën penale per te cilen ai akuzohet sipas aktakuzes.

- Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të pandehurin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 të KPRK-së, e si rrethane renduese gjykata ka vlerësuar, dashjen direkte të akuzuarit tek kjo veprë penale, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij në këtë veprë penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët, faktin se është ende student dhe i pa punë, ka të ardhura të vogla nga një pension invalidor, faktin se është i pa dënuar më parë, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedure tjetër penale.

Në rastin konkret kundër këtij të akuzuari gjykata vendosi që të aplikoj dispozitat e zbutjes së dënimit dhe të njëjtit i shqiptoj dënimin me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit nën minimumin e paraparë ligjor për këtë vepër penale, duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 71 par.1 pika 1.2 të KPRK-së, pasi që ky akuzuari ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët, faktin se është ende student dhe i pa punë, ka të ardhura të vogla nga një pension invalidor, faktin se është i pa dënuar më parë, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedure tjetër penale.

Gjykata zbutjen e dënimit ndaj të akuzuarit e ka bërë edhe nën kufirin e zbutjes të parapare në nenin 72 par.1 pika 1.3 të KPRK-se, në të cilën parashihet nëse për vepër penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prejse paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vjet burgim, andaj bazuar në këtë dispozite ligjore gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave të përcaktuara si më lart, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim të kushtëzuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit të paraparë me nenin 38 të KPRK-së, se i pandehuri në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 të KPP-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në mbështetje të nenit 39 par.3 nën par.3.2 të Ligjit nr.05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk pati, andaj gjykata për kërkesën pasurore juridike nuk vendosi fare.

Nga të cekurat si më lart, e duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 365 të KPP-se, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.100/2022, të datës 09.11.2022

Procesmbajtësja:

Edita Kelmendi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari

Mentor Hajraj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.